



Planifikimi Urban me Pjesëmarrje në Bashkinë e Orikumit

Qëllimi i projektit

Planifikimi Urban me Pjesëmarrje (PUP) në Orikum, është hartuar me qëllim që të përmirësojë qeverisjen vendore dhe besimin në bashkinë e Orikumit duke:

(i) ngritur kapacitetet e zyrtareve lokal dhe grupeve qytetare për t'u përfshirë në konsultime që janë të fokusuar dhe orientuar drejt zgjidhjes së problemeve të komunitetit dhe,

(ii) prezantimi i mekanizmave afatgjate dhe afatshkurter për institucionalizimin e zërit qytetar në vendimarrje në qeveri.

Objektivi afatgjate është krijimi i mundësive për përfshirje qytetare në vendimarrje. PUP është hartuar duke u mbështetur në kalendarin e buxhetit të qeverisjes vendore në bashkinë e Orikumit.

Fazat e projektit

FAZA I: PËRGATITJA DHE MOBILIZIMI I AKTOREVE KRYESORE

Faza e Përgatitjes dhe Mobilizimit të Aktorëve Kryesorë nis procesin e pjesëmarrjes në vendimarrje dhe kalon nëpërmjet hapave të mëposhtem:

- Mobilizimi i Aktorëve Kryesorë si ekspertë të njohur në fushën e planifikimit urban, historisë, kulturës, arkitekturës, shoqata, media dhe grupime qytetare;
- Profili i qytetit dhe çështjeve prioritare që shqetesojnë qytetarët. Kjo fazë u karakterizua nga një fushatë intensive informimi publik duke përdorur mediat elektronike dhe shtypin lokal, vizitat në shtëpitë e qytetarëve dhe mbledhjen e opinionit nëpërmjet anketimit të 200 qytetarëve dhe takimeve të hapura në të cilat morën pjesë rreth 200 persona

FAZA E II: ÇESHTJET PRIORITARE DHE ANGAZHIMI I AKTOREVE

Në këtë fazë u zhvilluan mbledhje me grupet e identifikuar në fazën e parë, për të ndarë



qytetin në zona prioritare. U zhvilluan shtatë mbledhje të hapura dhe shumë intervista me qytetarët që shërbyen si bazë për draftin e parë të zonimit të qytetit të Orikumit me pjesëmarrje.

Faza e III: FORMULIMI DHE IMPLEMENTIMI I STRATEGJISE

Analiza e informacionit dhe përgatitja e projektit të parë të zonimit funksional urban dhe rregullores funksionale të zonimit.

FAZA E IV – VAZHDIMESI DHE KONSOLIDIMI

Përgatitja e dokumentit final të zonimit funksional urban dhe rregullores përkatëse si dhe mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit. Bashkia tashmë ka një instrument modern planifikimi afatmesëm, "Rregulloren e Zonimit Funksional" si dhe "Hartën e Zonimit Funksional", të cilat do e udheheqin bashkinë dhe komunitetin e

Orikumit drejt një zhvillimi urban më eficient dhe të qëndrueshëm në pesë vitet e ardhshëm. Instrumenti i ri i planifikimit lehtëson bashkinë dhe qytetarët për të vlerësuar dhe ekzekutuar lejet e zhvillimit të cilat harmonizojnë interesat e qytetarëve dhe sigurojnë zhvillimin me planifikim të qytetit.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës/Komisioni i Granteve të Vogla për Demokracinë

KOHËZGJATIA:

Shtator 2008 – Shkurt 2009

PËRFITUESIT:

- ✓ Bashkia Orikum

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.